



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:125156
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05700903

Ac.nr.7027/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.T, të cilin me autorizim e përfaqëson G.Sh, avokate, kundër të paditurës Kompania “B”, të cilën me autorizim e përfaqëson J.B avokat, për kompensim demi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.152/18 e datës 26.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13/05/2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e të paditurës Kompania “B” dhe PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.152/18 e datës 26.07.2021, dhe lënda kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin ankimor C.nr.152/18 e datës 26.07.2021, ka vendosur si vijon:

I.APROVOHET kërkespadija e paditësit B.T, dhe DETYROHET e paditura Kompania “ B”, që paditësit, të ja pagua shumën prej 1,460.30€, në emër të kompensimit të dëmit material, i cili është shkaktuar në serën dhe pusin të cilit kanë qenë të vendosur në parcelën kadastrale 00030-2 ZK Kaçanik, e evidentura në certifikatën e pronës 941-17217/2019, edhe atë:

- për redimentin e specave shumën prej 397.80€, e domateve shumën prej 450€, për kastraveca shumën prej 87.50€, për prodhimin e marullës shumën prej 150€, për pastrimin e pusit shumën prej 250€ dhe pompën për ujitje në vlerë prej 150€) në tersi SI E BAZUAR.

Këtë shumë me kamat ligjore prej 8% , duke filluar nga data 24.07.2018 (nga data e paraqitje së padisë), deri ne pagesën definitive.

II. DETYROHET e paditura që paditësit të i’ja paguaj shumën si në pikën I të dispozitivit të këtijë aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 820,00€, të gjitha

këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të miratojë ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin ankimor ta ndryshoj apo ta prishë dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B.T, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 24.07.2018, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensim dëmi, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke arsyetuar se shumën prej 1,460.30€, e ka caktuar duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit vlerësues i cili në raportin e vlerësimit dhe në seancën gjyqësore ka konstatuar se dëmi është shkaktuar gjatë ndërtimit të rrugës, duke punuar në rregullimin e rrugës dhe nuk janë marr masa të nevojshme nga punë kryesi tani e paditura për parandalimin e hyrjes se ujërave nga rruga në pronën e paditësit e nga ky mos veprim ka ardhur deri tek dëmtimi i kulturave perimore të përshkruara me lart si dhe mbushja e pusit me ujë të ndotur dhe meqenëse këto dëme janë shkaktuar me kontributin e paditurës, gjykata duke u bazuar në kontratën e punës ka gjetur se e paditura ka marr për obligim që të mos i dëmtoj objektet për rreth dhe do të jetë përgjegjëse për të gjitha aktivitetet në vend punishte. Prandaj gjykata duke i pasur për bazë këtë fakt e ka gjykuar shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 136 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës kontestimore i ka marr konform nenit 451.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182.1 e lidhur me nenin 8, nenin 183 dhe nenin 184 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit e Kosovës, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa është e bazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe si rezultat nuk ka arritur që të vërteton drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike sepse në arsyetim të aktgjykimi, konstatohet se në bazë të kontratës së punës rezulton se e paditura ka marr për obligim që të mos dëmtoj objektet për rreth dhe do të jetë përgjegjëse për të gjitha aktivitetet në vend punishte, por një provë e tillë nuk

gjendet në shkresat e lëndës si dhe nuk është administruar gjatë shqyrtimit kryesor, mandej gjykata e shkallës së parë konstaton faktin relevant se e paditura ka qenë punë kryerëse në rregullimin e rrugës, por nuk e vërteton faktin vendimtar se punë kryerësi a ka vepruar sipas projekti të përpiluar nga investitori, apo në rastin konkret ka bërë tejkalim të projektit dhe si pasojë është shkaktuar dëmi i pretenduar, mandej Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, me procesverbalin e saj Nr.08-320/01-20435/18 e datës 02/07/2018, konstaton se dëmi i shkaktuar është nga reshjet atmosferike si pasojë e kryerjes së punimeve, i cili procesverbal nuk mund të paraqet provë të mjaftueshme për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë si dhe nga ky procesverbal nuk rezulton se e paditura ka qenë prezentë me rastin e vlerësimit të dëmit të pretenduar si dhe konstatimin e shkakut të dëmit, gjegjësisht paditësi nuk e ka bërë sigurimin e para provës me ekspertizë gjyqësore nga fusha përkatëse si dhe ky raport është kontradiktor dhe jo bindës sepse nuk është vërtetuar mjaftueshëm se deri te dëmi i pretenduar ka ardhur si rezultat i të reshurave atmosferike apo si pasojë e punimeve të kundërligjshme të paditurës si dhe nuk është vërtetuar fakti vendimtar se e paditura a ka pasur mundësi të parandaloj këtë dëm në këtë fazë të punimeve ndërtimore.

Gjatë procedurës gjyqësore objekt i të provuarit duhet të jenë të gjitha faktet relevante, të cilat janë në ndikim në vendosjen e çështjes. Gjykata ka për detyrë që gjendjen faktike të vërtetohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe në këtë drejtim duhet të kujdeset që të administrohen të gjitha provat të cilat janë thelbësore për epilogun e kontestit. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë pa e vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë, respektivisht pa vlerësuar vlefshmërinë e provave kontestuese dhe pa qartësuar bazën juridike të krijimit të detyrimit e aprovoj kërkesëpadinë e paditësit. Prandaj, shkeljet e tilla të cekura më lartë përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që të vërtetohet bazën juridike të kërkesëpadisë përmes provës materiale me ekspertizë të ndërtimtarisë, me qëllim që të vërtetohet faktin vendimtar se punimet e kryera nga e paditura deri në datën e ndodhjes së dëmit, a janë realizuar konform projektit dhe standardeve nga fusha e ndërtimtarisë, apo këto punime janë realizuar në kundërshtim me projektin dhe normat e ndërtimtarisë, gjegjësisht me prova materiale të vërtetohet se deri të dëmi i pretenduar, a ka ardhur si pasojë e faktorit natyre apo si rezultat i punimeve jo kualitative dhe varësisht nga vërtetimi i këtyre fakteve, të zbatohet drejta të drejtën materiale si dhe gjatë vendimmarrjes duhet ti vlerëson të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, me qëllim që të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.7027/21, me datë 13.05.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku